

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ALBANIAN DIGITAL VENTURES sh.p.k.**

**Neni 1
Emërtimi**

1.1 Emërtimi i Shoqërisë është **ALBANIAN DIGITAL VENTURES sh.p.k.**, (në vijim “Shoqëria”).

**Neni 2
Selia**

2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. Faik Konica, Ndërtesa 6, Shkalla 5, kati 4, Apartamenti 12, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3
Objekti i Shoqërisë**

3.1 Shoqëria ka si objekt veprimtarie si më poshtë vijon:

- Zgjidhjet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë por pa u kufizuar në programim, zhvillimin e uebit, testimin, mirëmbajtjen, dizajnin, mediat sociale, krijimin e përmbajtjes dhe shërbime të tjera dixhitale dhe të teknologjisë së informacionit brenda kornizës TIK të biznesit.

3.2 Gjithashtu për të realizuar objektin e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tregtar, që e vlerëson të dobishëm apo të nevojshëm për arritjen e qëllimeve të saj, në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Neni 4
Kohëzgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 5
Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ALL 100 (njëqind lekë).

5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e nënshkruar në shumën ALL 100 (njëqind Lekë) që përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë.



Neni 6 **Kontributet**

6.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar nga personat dhe në shumat si më poshtë:

1. Ilir Daci, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 05.08.1980 dhe banues në Rr. Ali Jonuz Frasholli (Kavaja), Ndërtesa 16, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr. 8, Njësia Bashkiake Nr. 8, 1017, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartës së identiteti me numër 034517807 dhe numër personal I00805142P, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i cili ka kontribuar në vlerën ALL 100 (njëqind lekë).

6.2 Sipas kontributeve të mësipërme, zotërimi i kuotave të Shoqërisë pasqyrohet si më poshtë vijon:

1. Ilir Daci, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 05.08.1980 dhe banues në Rr. Ali Jonuz Frasholli (Kavaja), Ndërtesa 16, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr. 8, Njësia Bashkiake Nr. 8, 1017, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartës së identiteti me numër 034517807 dhe numër personal I00805142P, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, e cila zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me kontributin e nënshkruar në shumën prej ALL 100 (njëqind Lekë), që përfaqëson 100 % (njëqind për qind) pjesë të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 **Transferimi i kuotave**

7.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 **Administratori/ët**

8.1 Me këtë akt emërohet si Administrator i Shoqërisë për një afat 5 (pesë) vjeçar personi si më poshtë:

Znj. Lorena Uliu, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 29.06.1985 dhe banuese në Rr. Halit Bega, Ndërtesa 22, Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e kartës së identitetit me numër 034813119 me nr. personal I55629048C, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

8.2 Kompetencat e Administratorit përcaktohen në Statutin e Shoqërisë.

Neni 9 **Kontakti i shoqërisë**

9.1 Email-i i shoqërisë është: info@albania-digital.com

9.2 Numri i kontaktit të shoqërisë është 44523110.



Neni 10
Kopjet

10.1 Ky Akt Themelimi është bërë në 3 (tre) kopje me vlerë të njëjtë secila.

ORTAKËT

Ilir Daci

ILIR DACI



Datë 05 Shkurt 2024